



MINISTRIA E KULTURËS
Nr. 3549 Prot.
Datë 31.05.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VE N D I M

Nr. 364, datë 29.5.2019

PËR

**FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN E ZHVILLIMIT
TË VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT KOMBËTAR
TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ligjit nr.90/2019, "Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të nenit 44, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VE N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Përcaktimin e funksionimit dhe të mënyrës së zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (referuar më poshtë IKTK).
2. IKTK-ja është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Tiranë.
3. IKTK-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.
4. IKTK-ja ka si mision gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale.
5. IKTK-ja vpron në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në fushat e përgjegjësisë, si më poshtë vijon:
 - a) Të trashëgimisë kulturore materiale;
 - b) Të arkeologjisë parandaluese të shpëtimit nëntokësor dhe nënujor;
 - c) Të pasurisë e peizazhit kulturor.

I. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË INSTITUTIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE, IKTK-SË

IKTK-ja ka përgjegjësi të organizojë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive në fushën:

- a) e trashëgimisë kulturore materiale në lidhje me gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale;
- b) e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUTIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE, IKTK-SË

1. IKTK-ja e shtrin veprimtarinë e tij për trashëgiminë kulturore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror. Në përbërje të strukturës së tij ka edhe Qendrën Rajonale për Konservim dhe Restaurim.
2. IKTK-ja është institucion kombëtar i specializuar shkencor, i cili në përbushje të funksioneve të veta bashkërendon punën me:
 - a) drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore (DRTK);
 - b) njësitë e administrimit dhe të koordinimit të parqeve arkeologjike (NJAKPA);
 - c) institucionet e vetëqeverisjes vendore.
3. IKTK-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e IKTK-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
4. Struktura dhe organika e IKTK-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
5. IKTK-ja funksionon në bazë të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, të këtij vendimi, statutit dhe rregullores së miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
6. IKTK-ja realizon aktivitetin e saj në bashkëpunim me:

- a) institucionet e tjera publike në varësi të ministrisë përgjegjëse të trashëgimisë kulturore, organet e administratës qendrore, organet e vetëqeverisjes vendore dhe institucione të tjera shkencore, kulturore, fetare, persona fizikë e juridikë për evidentimin, gjurmimin, konservimin, studimin dhe restaurimin e pasurive kulturore;
 - b) UNESCO-n, si dhe me organizata të tjera ndërkombe të lidhje me trajnimet për formimin profesional dhe specializimin e restauratorëve dhe operatorëve të rinj të trashëgimisë kulturore, pjesë të strukturave shtetërore dhe institucioneve të specializuara për trashëgiminë kulturore;
 - c) institucione të tjera të specializuara të sistemit të Akademisë së Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, si dhe institucion homologe ose organizma ndërkombe të, në fushën e trashëgimisë kulturore.
7. Statuti dhe rregullorja, që përcaktojnë metodat e brendshme të punës së IKTK-së, miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
8. Marrëdhëni e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve të IKTK-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.
9. Drejtori i Përgjithshëm i IKTK-së duhet të plotësojë kriteret profesionale, si më poshtë vijon:
- a) Eksperiencë profesionale dhe të dokumentuar në fushën e tij të ekspertizës dhe të menaxhimit;
 - b) Nuk duhet të jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
10. IKTK-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:
- a) Monitoron dhe koordinon DRTK-të, si njësi përgjegjëse përmbarëvajtjen e tyre;
 - b) Konstaton verifikimin ose jo, të interesit kulturor për pasuritë e paluajtshme sipas procedurave përkatëse në ligjin për trashëgiminë kulturore;
 - c) Nëpërmjet sekretarisë teknike kryen verifikimet e natyrës teknike dhe siguron nga kërkuesit informacione të tjera shtesë në funksion të vendimmarjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, lidhur me kërkesat për ndërhyrje;
 - ç) Vendos pezullimin e menjëhershëm të ndërhyrjeve kur me propozim të institucioneve të specializuara ose kryesisht konstaton kryerjen e punimeve në kundërshtim me ligjin;

- d) Monitoron ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve të licencuara;
- dh) Kryen formimin e vazhdueshëm të personave të pajisur me licenca në fushën e projektimit e të zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore materiale, veprimtarisë arkeologjike;
- e) Kryen studime për shtrirjen e zonës së mbrojtur për pasuritë kulturore të paluajtshme ose grupimin e pasurive kulturore të paluajtshme;
- ë) Vendos masat e mbrojtjes indirekte, sipas procedurës së parashikuar në ligj;
- f) Propozon procedurën për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike;
- g) Koordinon planet e zhvillimit, të projekteve restauruese dhe konservuese, projekteve kërkimore-shkencore të NJAKPA-ve;
- gj) Ndjek gjetjet rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore ose punimeve të tjera të çfarëdollojshme dhe merr masa për shpëtimin e këtyre vlerave, sipas procedurës së parashikuar në ligj;
- h) Nëpërmjet punonjësit të autorizuar pezullon punimet që mund të dëmtojnë vlerat arkeologjike deri në marrjen e një vendimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në rastin e zbulimeve të rëndësishme;
- i) Regjistron njoftimet për gjetjet rastësore detare dhe nëntokësore;
- j) Studion dhe përcakton kufijtë e zonave të mbrojtura të pasurive kulturore;
- k) Konsulton ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidhur me hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rijetëzim për vlerat kulturore të paluajtshme;
- l) Së bashku me IKRTK-në harton masat për ruajtjen, mbrojtjen, mirëmbajtjen, administrimin, tjetërsimin dhe qarkullimin e objekteve muzeore dhe të koleksioneve muzeore;
- ll) Kryesisht ose me propozim të institucioneve të specializuara të njësive të qeverisjes qendrore ose të vetëqeverisjes vendore fillon procedurën e vlerësimit, duke verifikuar ekzistencën e interesit të veçantë publik për pasuritë e peizazhit kulturor për pasuritë e paluajtshme dhe për zonat për të cilat është marrë iniciativa;
- m) Lëshon lejet e peizazhit kulturor pas miratimit të kërkesës nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, si dhe i sugjeron Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale vendosjen e distancave, masave/hapësirave dhe variante të projektit në fazë ekzekutimi të nevojshme për ruajtjen e vlerave të peizazhit;
- n) Përgatit dhe realizon në mënyrë periodike botime të ndryshme shkencore, albume dhe udhërrëfyes;
- nj) Nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim formon dhe përditëson njohuritë e restauratorëve dhe të subjekteve të licencuara;

- o) Nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim harton dhe zbaton programe të kualifikimit të specialistëve në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;
 - p) Çdo detyrë tjeter të përcaktuar me ligj.
- 11. Drejtori i Përgjithshëm i IKTK-së ka kompetencat dhe përgjegjësitë, si më poshtë vijon:
 - a) Analizon, zbërthen dhe siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikat e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
 - b) Është përgjegjës për hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike në përputhje me objektivat dhe misionin e IKTK-së;
 - c) Monitoron dhe kontrollon faktorët e riskut që venë në rrezik arrijen e objektivave të IKTK-së;
 - c) Planifikon, drejton dhe koordinon funksionimin e përgjithshëm të institucionit;
 - d) Shpërndan punën brenda institucionit dhe siguron arrijen e rezultateve në kohë dhe me cilësi, sipas objektivave të planifikuara;
 - dh) Është sekretar i Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale;
 - e) Jep udhëzime lidhur me trajtimin e kërkesave që i kalojnë për shqyrtim Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale;
 - ë) Ndjek dhe raporton për detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe institucionet e tjera;
 - f) Emëron dhe shkarkon punonjësit e IKTK-së, në bazë të Kodit të Punës dhe të rregullores së brendshme të IKTK-së;
 - g) Ndjek rregullisht proceset administrative dhe merr masa për zgjidhjen e problemeve.
- 12. IKTK-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e IKTK-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet “Republika e Shqipërisë”, Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.”
- 13. Vula e IKTK-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, të kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohet ministri i Kulturës që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të fillojë procedurën për propozimin e strukturës dhe të organikës së IKTK-së.

Drejtuesit e institucioneve aktuale që ristrukturohen në funksion të ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore", me urdhër të përbashkët, krijojnë një komision për realizimin e procesit të ristrukturimit dhe të riorganizimit të punonjësve aktualë të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Agjencisë Shërbimit Arkeologjik, sipas strukturës dhe organikës së re. Ky proces udhëhiqet nga drejtues të lartë të Ministrisë së Kulturës, nën mbikëqyrjen e ministrit të Kulturës.

3. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të IKTK-së, sipas këtij vendimi, strukturat aktuale vazhdojnë funksionimin e tyre sipas strukturave dhe organikave të miratuara.
4. Ngarkohet Ministria e Kulturës që, në përputhje me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të bëjë transferimin e fondeve buxhetore nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Agjencia e Shërbimit Arkeologjik te IKTK-ja.
5. Ngarkohen ministri i Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore si dhe institucionet e tjera në fushën e trashëgimisë kulturore përzbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA


Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

MINISTRI I KULTURËS

ELVA MARGARITI



The handwritten signature of Erion Brace is written in black ink. It consists of stylized, cursive letters that appear to read "Brace" followed by a date, possibly "10.07.19".